



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kodi i lëndës: INF 272
Lënda: Okulistikë - ORL

PROGRAMI I LËNDËS Okulistikë - ORL									
Titullari i lëndës:		Ela Peto Dr në Shkenca paraklinike _____							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
	6 ECTS	Leksion	Seminar	Usht	Praktikë	Projekt	Total		
	6 ECTS	45	0	0	30	0	75	75	150
Tipologjia e lëndës		Lëndë ndërdisiplinore / integruese							
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti II, Semestri I							
Lloji i lëndës		Me zgjedhje							
Programi i studimit		Bachelor në Infermieri Mami							
Kodi i lëndës		INF 272							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		ela.peto@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Okulistika është shkenca që studion ndërtimin dhe funksionimin e syrit. Studenti në këtë specialitet do të marrë informacion mbi anatominë, fiziologjinë, fizpatologjitë e syrit dhe kujdesin infermior për shumë sëmundje të syve. Otorinolaringologjia (ORL) është shkenca që studion veshin, fytyrën, hundën dhe gypin trakeobronkial. Në këtë specialitet student merr informacion mbi anatominë e veshit, sëmundjet më të shpeshta në ORL dhe asistencën infermiore
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">▪ Do të njihen me Objektin e studimit shkencave më të bukura të Mjekësisë: Okulistikë/ ORL▪ Do të kenë njohuri të mjaftueshme për anatominë, fiziologjinë dhe fizpatologjitë e syrit/▪ Do të mund të realizojnë kujdesje infermiore për shumë sëmundje që studion kjo shkencë.▪ Do të dinë të realizojnë përkujdesjet infermiore në rastet emergjente.▪ Do të kenë njohuri të mjaftueshme për anatominë veshit, hundës, laringut, faringut.▪ Do të mund të realizojnë kujdesje infermiore për shumë sëmundje që studion kjo shkencë.▪ Do të dinë të realizojnë përkujdesjet infermiore në rastet emergjente.
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: ☞ Të njohin parimet e praktikës infermiore në trajtimin e sëmundjeve në Pavionin e Okulistikës ORL. ☞ Të njohin dhe të realizojnë përkujdesjet infermiore në këtë pavion ☞ Të njohin rëndësinë e e parandalimit të transmetimit të infeksioneve gjatë përkujdesjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

KONCEPTET THEMELORE

1. Parimet baze te perkujdesjeve infermierore ne Oftalmologji e Otorinolarologji.
2. Përkujdesjet shëndetësore gjatë gjithë jetës.
3. Promocioni shëndetësor dhe parandalimi i kufizimit te shikimit.
4. Administrimi i medikamenteve ne Oftalmologji.
5. Ndhma infermierore në situatat emergjente te semundjeve te syve.
6. Parimet baze te perkujdesjeve infermierore ne Otorinolarologji
7. Anatomia dhe Fiz-patologjia ne semundjet e veshit,hundes,laringut,faringut.
8. Promocioni shëndetësor dhe parandalimi i infeksioneve .
9. Ndhma infermierore në situatat emergjente ne ORL.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Tema 1- Njohja me programin e modulit dhe kërkesat e lëndës. Tema 2- Anatomia e syrit <i>Njohja me kerkesat e lendes si dhe pjeset perberese te syve</i> Tema 3- Fiziologjia e syrit . <i>Njohja me fizpatologjine e syrit</i> Praktike mesimore- Asistenca infermierore gjatë ekzaminimeve të aparatit okulo-motor.	<i>fq. 3-13</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
II.	Tema 4- Anatomia patologjike e syrit Tema 5- Metodrat e ekzaminimit në sëmundjet e syrit Tema 6- Sëmundjet e organeve aksesore të syrit (kapak, vetulla, organet e lotit) <i>Oftalmoskopia biomikroskopia angiografia tomografia e kompjuterizuar skiaskopia etj metodat me efikase per ekzaminimin adekuat te syve. Patologjite e kapakeve te syve.</i> Praktike mesimore- Kujdesi infermieror në kufizimin e shikimit.	<i>fq. 14-21</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
III.	Tema 7- Sëmundjet e konjuktivës <i>Konjuktivitete kataraktat dhe keratitet. Klinika Kujdesi infermieror dhe trajtimi i tyre.</i> Tema 8- Sëmundjet e kristalinës. Sëmundjet e kornes Tema 9- Sëmundjet e Skleres. <i>Skleritet episkleritet klinika trajtimi</i> Praktike mesimore- Kujdesi infermieror tek hantikapët me verbëri të pjesshme	<i>fq. 22- 32</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
IV.	Tema 10- Sëmundjet e shtresës vaskulare. <i>Kujdesi infermieror ne uveitet akute dhe kronike</i> Tema 11- Sëmundjet e retinës. Aksidentet e retinës. <i>Retinopatite diabetike kujdesi infermieror dhe trajtimi .</i> Tema 12- Glaukomat me kend te hapur dhe me kend te mbyllur <i>Rritja e tensionit te brendshem te syrit nje nga semundjet me prognoze te keqe nqs nuk trajtohet ne kohe. Klinika klasifikimi dhe trajtimi</i>	<i>fq. 33- 52</i> <i>fq. 58 - 66</i> <i>fq. 67- 74</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	Praktike mesimore - Kujdesi infermieror tek hantikapët me verbëri të plotë		<i>Praktikë 2 orë</i>
V.	Tema 13 - Anomalite e Refraksionit. Tema 14 - Sëmundjet e nervit të të parit Tema 15 - Strabizmi. <i>Anomalite e perthyerjes se drites menytrat e trajtimit klinika . Neuritet klinika trajtimidhe kujdesi infermieror.</i> Praktike mesimore - Sëmundjet e konjuktivës	<i>fq. 75 - 80</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
VI.	Tema 16 -Traumat e syrit Tema 17 - Verbëria <i>Alfabeti Brail – Shume i rendesishem ne komunikimin me persona te verber.</i> Tema 18 - Kujdesi infermieror në kufizimin e shikimit Praktike mesimore - Sëmundjet e kristalinës	<i>fq. 81-87</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
VII.	Tema 19 - Kujdesi infermieror tek hantikapët me verbëri të pjesshme Tema 20 - Kujdesi infermieror tek hantikapët me verbëri të plotë <i>Menytrat me efikase ne trajtimin e personave me humbje te shikimit te pjesshem ose te plote</i> Tema 21 - Kujdesi infermieror ne djegiet nga bazat dhe acidet. <i>Trajtimi ne rastet emergjente te djegjeve me baza dhe acide si dhe rastet me djegje nga lapsi kopjativ. Trajtimi ne heqjen e copave intraokulare .</i> Praktike mesimore - Sëmundjet e kornes	<i>fq. 88–94</i> <i>fq. 95 - 100</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
VIII.	Tema 22 -Vitaminat . <i>Rendesia e perdorimit te vitaminave nepermjet ushqyerjes ne semundjet e syve dhe jo vetem</i> Tema 23 - Semundjet e Orbites. <i>Klinika trajtimi dhe perkujdesjet infermiore ne traumat e orbites.</i> Tema 24 - Kujdesi infermieror ne semundjet me te shpeshta te syve <i>Njohja me semundjet me te shpeshta dhe metodat e perkujdesjeve adekuate infermiore.</i> Praktike mesimore Sëmundjet e shtresës vaskulare	<i>fq. 101 - 103</i> <i>fq. 104 - 106</i> <i>fq. 107 - 110</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
IX.	Tema 25 - Mjekimi dhe Farmakologjia okulare <i>Klasifikimii barnave dhe perdorimi i gjere i tyre ne Okulistike.</i> Tema 1 - Anatomia dhe Fiziologjia e veshit <i>Studenti do te marre njohuri per anatomine dhe fiziologjine e veshit</i> Tema 2 - Metodat e ekzaminimit për sëmundjet e veshit dhe laringut <i>Njohja me metodat me te reja diagnostikuese ne Otorinolaringologji</i> Praktike mesimore - Sëmundjet e retinës	<i>fq. 111- 115</i> <i>fq.122- 129</i> <i>fq.130-133</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Praktikë 2 orë</i>
X.	Tema 3 -. Semundjet e veshit të jashtëm dhe kujdesi infermieror.	<i>fq.134-137</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	<p><i>Vleresimi me semundjet e veshit te jashtem dhe nderhyrjet kirurgjikale qe aplikohen per korrigjimin e tyre</i> Tema 4- Semundjet inflamatore të veshit të mesëm, kujdesi infermieror. <i>Vleresimi i semundjeve inflamatore te veshit te mesem si mund te jene otitet e mesme akute ose kronike</i> Tema 5- Otitet e mesme akute dhe kronike të qelbëzuara <i>Njohja dhe vleresimi i otiteve qe ne fazat fillestare eshte thelbesor per nje sherim sa me te shpejte te pacientit</i></p> <p>Praktike mesimore- Kujdesi infermieror në kufizimin e dëgjimit</p>	<p><i>fq.138-141</i></p> <p><i>fq.142-145</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XI.	<p>Tema 6- Otoskleroza dhe asistenca infermierore . <i>Njohja me semundjen e veshit te brendshem dhe asistencen infermierore</i> Tema 7- Semundja Menier dhe crregullimet e labirintit <i>Njohja me semundjet e veshit te brendshem dhe trajtimin e tyre</i> Tema 8- Kujdesi infermieror në traumat e veshit</p> <p>Praktike mesimore- Kujdesi infermieror ne perikondrite</p>	<p><i>fq.146-147</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XII.	<p>Tema 9- Çrregullimet nervore të dëgjimit, kujdesi infermieror Tema 10- Anatomia e faringsit, laringsit dhe hundës <i>Njohja me anatomine e laringut, faringut dhe hundes per te vleresuar me vone patologjite e tyre</i> Tema 11- Semundjet e laringsit dhe kujdesi infermieror</p> <p>Praktike mesimore- Kujdesi infermieror në tonsilitet kronike</p>	<p><i>fq.148-150</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XIII.	<p>Tema 12- Rinitet (inflamatorë dhe alergjike), inflamacionet e sinuseve paranazale dhe trajtimi i tyre <i>Vleresimi i inflamacioneve te sinuseve dhe korrigjimi i tyre me me metodat me bashkekohore</i> Tema 13- Anginat, shenjta klinike e mjekimi i tyre <i>Tonsilat palatine shkak i shume semundjeve te organizmit. Njohja dhe vleresimi i tyre ne rruge konservative dhe kirurgjike</i> Tema 14- Sinuzitet, akute dhe kronike.</p> <p>Praktike mesimore- Kujdesi infermieror në otitet e jashtme purulente</p>	<p><i>fq.151-158</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XIV.	<p>Tema 15- Sëmundjet neoplazike në ORL Tema 16- Faringitet akute dhe kronike Tema 17- Traumat dhe stenoza e laringut <i>Vleresimi dhe njohja e traumave te ndryshme ne Otorinolaringologji. Faringitet dhe laringitet e pa trajtuara mire dhe korrigjimi i komplikacioneve qe mund te japin</i></p> <p>Praktike mesimore- Kujdesi infermieror ne sinuzite, laringite faringite</p>	<p><i>fq.158-163</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XV.	<p>Tema 18- Ekzaminimi i hundës dhe sinuseve paranazale Tema 19- Kujdesi infermieror ne rastet me epistaxis <i>Nderhyrjet kirurgjikale me bashkohore per trajtimin e traumave te hundes dhe sinuseve paranazale. Trajtimi i rasteve me epistaksis qofte duke perdorur tamponaden anteriore dhe ate posteriore</i> Tema 20- Farmakologjia në Otorinolaringologji</p>	<p><i>fq.163-166</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	Praktike mesimore - Asistenca infermierore gjatë ekzaminimeve të aparatit të dëgjimit		<i>Praktikë 2 orë</i>
--	--	--	-----------------------

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e laboratorit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e laboratorit në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
Mënyra e vlerësimit	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	1- 15 leksione	30 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	16 – 45 leksionet	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar*	Java 14/15	Detyra e kursit	10 pikë	Prezantim me gojë	Vlerësim i performancës të praktikës infermierore /paraqitja e detyrës së kursit
	<p>*Vlerësim i vazhduar -Do të realizohet prej pedagogut të praktikës për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të vlerësohen për performancën në praktika . Kësaj performancë i shtohet dhe paraqitja e detyrës së kursit .</p> <p style="text-align: center;">Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:</p>					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10

LITERATURA

a. Literatura bazë e detyruar	“Okulistikë – ORL ”D.Selfo , 2018 (Cikël leksionesh) ISBN 978-9928-283-03-0
b. Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none"> ○ Prof.Dr. Pjerin Radovani:Dr.Sh.M. Besim Boci “ Semundjet e veshit, hundes dhe grykes” ISBN 978-99956-26-86-0 ○ ‘Okulistika’ S. Zhugli 2011 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) ○ Eyes: Injury, Illness and Health’ Carol Ballard, 2009 ○ Ophthalmic Pathology’ Weng K Sehu, William Lee 2006



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione ,praktika dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo pune me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.